

PËRSHKRIMI

ColorTech Green, është ngjyrë e lëngshme e krijuar posaçërisht për t'u përdorur në betonime me spërkatje, i cili mund të përdoret në të gjitha klasat e betonit, nuk ndikon negativisht në qëndrueshmërinë e betonit dhe përmirson punueshmërinë.

FUSHA E APLIKIMIT

- Në të gjitha klasat e përshkruara të betonit të gatshëm në EN 206 dhe EN 13515.
- Aplikime betoni me raporte të ulëta uj / çimento.
- Aplikimet për betonin e papërshkueshëm nga uji.
- Në prodhimin e betonit vetë-kompakt dhe vetë-konsolidues.
- Aplikimet sipërfaqësore të lëmuara si në ura e viadukte.
- Në ndërtimin e të gjithë elementëve të ndërtesës.
- Para prodhimit të betonit me spërkatje.

KARAKTERISTIKAT

- ColorTech Green, siguron një sipërfaqe të lëmuar dhe me ngjyrë në beton.
- Rrit rezistencën e betonit të ngurtë ndaj kushteve të mjedisit.
- Nuk përmban klorure. Nuk shkakton korrodimin e armaturave.
- Siguron ngjyrosjen e betonit duke përdorur dozën e duhur sipas preferencës së klientit.

PËRDORIMI

- ColorTech Green, shtohet në mikser gjatë prodhimit ose edhe në mikser (mobil) para derdhjes së betonit.
- Nëse do ti shtohet në mikser (mobil) duhet të përzihet dy minuta për çdo m³

SASIA E PËRDORIMIT

Në prodhimin e çdo klase të betonit sipas standardeve EN 206 ve EN 13515 rekomadohet përdorimi prej 2 kg /m³ deri 6 kg/m³. Ky raport mund të ndryshon sipas çimentos, agregatit, përbërjes minerale, përbërësve të ujit dhe gjithashtu sipas kërkesave tjera që mund ti kem.Pra para se të bëhet përcaktimi i sasisë që do të përdoret, merren parasysh kërkesat dhe pasi bëhen testet laboratorike përcaktohet sasia.

KUSHTET E RUAJTJES DHE PAKETIMI

Produkti duhet të ruhet mbi 5 ° C. Nëse produkti ngrihet, duhet të përzihet mekanikisht pas shkrirjes. Jetgjatsia e saj është 1 vit.

Shitet në sasi prej 1100kg

PËRPUTHSHMËRIA

ColorTech Green është i përputhshëm me, ExtraTech, AirTech, FreezeTech, RetarTech, ProofTech. Ju lutemi të kontaktoni mbështetjen teknike të TechnoChem për pajtueshmërinë me kontribute të tjera. Nëse më shumë se një shtesë (aditiv) duhet të përdoret në recepturën e dëshiruar, secila shtesë duhet të shtohet në përzierje veç e veç.

ColorTech Green, Mund të përdoret me të gjitha llojet e çimentos që përputhen me standardin EN 197-1 . Rekomandohet të kontaktoni njësinë mbështetëse teknike TechnoChem për përdorim në lloje të veçanta të çimentos.

INFORMACION MBI SIGURINË

Kontaktet e lëkurës dhe syve me adetivin duhet të parandalohen, në rast kontakti lani me shumë ujë. Në rast të kontaktit me sytë, shpërlajeni menjëherë me shumë ujë dhe kërkoni këshilla mjekësore.

Për informacion të mëtejshëm ju lutemi referojuni fletës së të dhënave për sigurinë e materialit (MSDS) të produktit.